



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Tiranë më 25 06 2024

Nr 970/5 Prot

V E N D I M

Nr. 16 datë 25.06.2024

P Ë R

“SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL TË SIPËRMARRËSIT VODAFONE ALBANIA SH.A, PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT 900 MHZ (SASI SPEKTRI 4 MHZ, I ÇIFTUAR) DHE BREZIT 1800 MHZ (SASI SPEKTRI 9 MHZ, I ÇIFTUAR)”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës _____.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkzionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Autorizimeve, shqyrtoi kërkesën me objekt:

- *Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri 4 MHz, i çiftuar) dhe brezit 1800 MHz (sasi spektri 9 MHz, i çiftuar).*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 114, dhe neni 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (ligji nr. 9918/2008);

2. Neni 67, i Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
3. Pika 2, Kreut IV, të VKM-së nr.496, datë 22/07/2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” (VKM nr. 496/2014);
4. Rregullore e brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar me VKD Nr. 4 datë 11.02.2019;

KËSHILLI DREJTUES I AKEP


Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
2. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si edhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

V Ë R E N:

1. Me Vendimin nr. 745, datë 26.06.2009, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimit individual ish sipërmarrësit Plus Communications sh.a, për përdorimit të frekuencave të brezave 900 dhe 1800 MHz dhe ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (telefoni e lëvizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë. Sasia e spektrit të alokuar ishte: 8 MHz (i çiftuar), në brezin 900 MHz dhe 9 MHz (i çiftuar), në brezin 1800 MHz.
2. Me Vendimin Nr. 21, datë 01.12.2017, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimeve Individuale sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, si rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek Vodafone Albania sh.a. Sipërmarrësi Plus Communication sh.a ka mbyllur rrjetin dhe shërbimet në 31.12.2027, ndërsa frekuencat e caktuara me këtë vendim, kanë filluar të përdoren nga Vodafone Albania sh.a, nga data 01.01.2018.
3. Me Vendimin Nr. 4, datë 25.05.2023 Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar “Pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”, i ndryshuar me VKD Nr. 11, datë 12.10.2023. Pjesa e spektrit të ish Plus Communications sh.a, që mbetet tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.,a përbëhet nga: një sasi spektri prej 4 MHz (i çiftuar), në brezin 900 MHz dhe një sasi spektri prej 9 MHz (i çiftuar), në brezin 1800 MHz.



4. Me shkresën nr. 970/1 prot., datë 24.05.2024, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, ka paraqitur aplikim për rinovimin e Autorizimeve Individuale për sasinë prej 4 MHz në brezin e frekuencave 900MHz dhe sasinë 9 MHz në brezin e frekuencave 1800MHz.
5. Me Vendimin nr. 14 datë 18.06.2024, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar Raportin Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz, nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.
6. Në zbatim të pikës 7, të Kreut II, të VKM nr. 496/2014, i ndryshuar, Raporti Përmbledhës i Vlerësimit i Grupit të Punës, shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual, i është dërguar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për vijimin e procedurave të mëtejshme, të përcaktuara në këtë VKM.
7. Në legjislacionin material dhe atë sekondar është parashikuar/rregulluar efektivisht momenti procedural i zgjatjes së procedurave të rinovimit përtej afateve ligjore, si dhe duke pasur në vëmendje se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte dëm të pariparueshëm mbi interesin publik dhe të drejtave/interesave të ligjshme të palëve, në përmbushje të plotë të objektivave rregullatore të parashikuar nga neni 7, i Ligjit 9918/2008, të faktit se ekzistojnë parakushtet e përcaktuara në nenin 11, të ligjit 44/2015 për ushtrimin e autoritetit publik në mënyrë diskrecionare, ruan të drejtën për të marrë *suo motu* vendim të ndërmjetëm për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, deri në disponimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftimit mbi përfundimin e procedurës së negocimit.
8. Neni 67, i Ligjit nr. 44/2015 “Vendimet e Ndërmjetme”, është i zbatueshëm në të gjitha fazat e një procedure administrative, dhe se marrja apo jo e një vendimi të tillë është tërësisht në diskrecion të organit publik kompetent. Për më tepër VKM nr. 496 datë 22/07/2014 “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrencë”, i ndryshuar, në Kreun IV të tij, i njëjtit tagrin AKEP që të ushtrojë të drejtën e marrjes së Vendimeve të ndërmjetme në kushtet dhe rrethanat e parashikuar në këtë VKM.
9. Është e rëndësishme të theksohet se një vendimmarrje e tillë nga AKEP, është realizuar edhe më parë nga KD i AKEP, në rastin e rinovimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit Telekom Albania (VKD nr. 2494 datë 14.08.2014 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual në brezat 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Telekom Albania”) dhe në rastin e rinovimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit Albtelecom sh.a (VKD nr. 29 datë 16.08.2019 “Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual në brezat 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”).

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 114, të Ligjit nr.9918/2008, nenit 67 të Ligjit Nr. 44/2015, pikës 2, të Kreut IV të VKM nr. 496/2014, i ndryshuar dhe Rregullore e brendshme e Funkcionimit të

Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7 datë 16.02.2017, e ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri 4 MHz, i çiftuar dhe brezit 900 MHz (sasi spektri prej 9 MHz, i çiftuar), në brezin 1800 MHz, miratuar me VKD Nr. 4 datë 25.05.2023 i ndryshuar, deri në marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negocimit me sipërmarrësin One Albania sh.a, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 496/2014, i ndryshuar.
2. Të njoftohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, për këtë vendimmarrje.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Lorenc Bako

Armer Juka

